



Mjedisi i Evropës 2025

Profilet e vendeve

KOSOVA



Shtator, 2025

Profili i Kosovës në raportin “Mjedisi i Evropës”

Profili i Kosovës në raportin “Mjedisi i Evropës” ofron një përmbledhje të shkurtër të prirjeve kryesore në tre fusha: mjedis dhe klimë, ndryshime socio-ekonomike, dhe transformimet sistematike (në sektorët e energjisë, transportit dhe ushqimit). Ai thekson zhvillimet dhe sfidat kryesore në këto fusha, përfshirë masat që mbështesin përparimin drejt qëndrueshmërisë në Kosovë.

Vlerësimi për secilën nga këto tri fusha është përgatitur nga ekspertë kombëtarë të Rrjetit Evropian të Informacionit dhe Vëzhgimit të Mjedisit (EIONET) në Kosovë, duke u bazuar në 20 tregues të miratuar nga EEA ose Eurostat.

Kosova ndodhet në një moment vendimtar në rrugëtimin e saj drejt qëndrueshmërisë mjedisore. Ndërsa po forcon përpjekjet në energjinë e ripërtëritshme, ekonominë qarkore dhe bujqësinë e qëndrueshme, vendi përballet edhe me sfida të mëdha, si varfëria energjetike, menaxhimi joefikas i mbeturinave, varësia e lartë nga lëndët djegëse fosile dhe fragmentimi i tokës bujqësore.

Megjithëse pyjet mbeten një rezervuar i rëndësishëm i karbonit dhe bujqësia organike po zgjerohet gradualisht, sektori bujqësor në Kosovë vazhdon të jetë burim ndotjeje dhe emetues i gazeve serrë. Politikat për tranzicionin energjetik po fuqizohen, me rritje të investimeve në energjinë diellore dhe atë me erë, si dhe me programe efikasiteti të mbështetura nga Qeveria e Kosovës dhe nga fondet e BE-së.

Ndërkohë, reformat në transport dhe lëvizshmëri synojnë të ulin emetimet dhe të rrisin qasjen në opsione më të gjelbra të udhëtimit. Ekonomia qarkore ende është në fazat e hershme, por strategjitë kombëtare dhe inovacionet në biznese po hapin rrugën për zhvillimin e saj.

Tranzicioni i Kosovës mbështetet nga një vetëdije në rritje për mjedisin dhe harmonizimi i politikave me objektivat e BE-së, por zgjerimi i veprimit në të gjitha sektorët do të jetë thelbësor për të arritur synimet klimatike, për të mbrojtur biodiversitetin dhe për të siguruar një tranzicion të drejtë për të gjithë qytetarët.

1. Mjedisi dhe Klima

Analiza e trendeve dhe vlerësimeve: Përparimi i vendit drejt synimeve të vitit 2030

	E arritur: Nivelet aktuale kanë arritur tashmë synimin e vitit 2030
	Në rrugën e duhur: Synimi do të arrihet duke ndjekur trendin historik
	Nevojitet përshejtim: Synimi nuk do të arrihet duke ndjekur trendin historik
	Drejtim i gabuar: Trendi historik nuk është duke shkuar në drejtimin e synuar
	Nuk është vlerësuar: Standardi nuk zbatohet ose mungesë të dhënash

1.1. Vlerësim përmbledhës

Gjatë 10 viteve të fundit, Kosova ka bërë përparim të dukshëm në rritjen e burimeve të energjisë së ripërtëritshme, uljen e ndotjes dhe zgjerimin e zonave të mbrojtura. Megjithatë, reduktimi i emetimeve të gazeve serrë (GHG), transformimi i sistemit energjetik dhe zhvillimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave mbeten sfida serioze.

Pyjet, që përbëjnë rreth 47 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës, janë rezervuari më i madh i karbonit dhe kanë një ndikim të rëndësishëm në trendet e përdorimit dhe ndryshimit të tokës, si dhe në sektorin e pylltarisë [1].

Emetimet totale të gazeve serrë në Kosovë kanë qenë pothuajse të qëndrueshme që nga viti 2008, ndërsa sektori i energjisë mbetet burimi kryesor i tyre [2]. Pjesëmarrja e burimeve të energjisë së ripërtëritshme në prodhimin total të energjisë është rritur në mënyrë të moderuar gjatë viteve të fundit. Ndërmjet viteve 2008 dhe 2020 është vërejtur rritje lineare e konsumit përfundimtar të energjisë, me ndërtesat, transportin dhe industrinë si sektorët më energji-përdorues [3].

Burimet kryesore të emetimeve të grimcave të imta (PM) janë djegia në shkallë të vogël, transporti dhe industria. Reduktimi i tyre ka çuar në ulje të koncentrimave të grimcave të imta dhe të emetimeve të prekursorëve të grimcave dytësore në ajër ndërmjet viteve 2005 dhe 2021 [4] [5].

Gjenerimi i mbeturinave komunale në Kosovë ka shënuar rritje të përgjithshme gjatë dekadës së fundit [6] [7]. Shumica e këtyre mbeturinave depozitohen në deponi sanitare, dhe sasia e deponuar çdo vit është në rritje të vazhdueshme. Kosova është ende në fazat e para të zhvillimit të infrastrukturës për ekonominë qarkore, përfshirë dhe politikat kombëtare përkatëse. Norma e përdorimit qarkor të materialeve është rritur shumë pak (vetëm 3.6 %) ndërmjet viteve 2010 dhe 2022 [8] [9].

Për të arritur objektivat ambicioze të riciklimit të mbeturinave komunale dhe për të kapërcyer pengesat në zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkore, nevojiten përpjekje shtesë për përmirësimin e sistemit të grumbullimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave [10] [11].

1.2. Treguesit për Mjedisin dhe Klimën

Sipërfaqja e tokës e dedikuar për bujqësinë organike

Treguesi paraqet përqindjen e tokës bujqësore në BE që përdoret për bujqësi organike dhe distancën nga synimi i vendit për arritjen e një përqindjeje prej 25 %, siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane (European Green Deal).

Nevojitet përshejtim: Synimi nuk do të arrihet nëse vazhdohet me trendin historik të deritanishëm




Figura 1: Pjesa e sipërfaqes totale bujqësore të shfrytëzuar e konvertuar ose në proces konvertimi në bujqësi organike.

Burimi i të dhënave: *Organic crop area by agricultural production methods and crops*, Eurostat

Në Kosovë, bujqësia organike përbën vetëm 0.47 % të sipërfaqes totale të përdorur bujqësore. Gjatë periudhës 2012–2022, kjo përqindje është rritur me 0.43 pikë përqindjeje, nga 0.03 % sa ishte më herët ¹. Duke u bazuar në trendet aktuale, Kosova synon ta zgjerojë bujqësinë organike me 2.500 hektarë deri në vitin 2026². Megjithatë, krahasuar me vendet anëtare të BE-së, të cilat kanë synime prej 25 %, Kosova përballlet me sfida për të arritur një rritje të ngjashme³.

¹ <https://statistics.fibl.org/europe/key-indicators.html>

² https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/PVBO_2023_2026.pdf

³ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/org_cropar_custom_10351840/default/table?lang=en

Që nga viti 2018, zhvillimi i këtij sektori është nxitur nga rritja e subvencioneve nga buxheti i shtetit, të cilat janë rritur nga 29 648 € në vitin 2018 në 57 527 € në vitin 2022^{4,5}.

Kjo rritje mbështetet gjithashtu nga programe të financuara nga donatorë. Ka një interesim në rritje nga fermerët dhe konsumatorët për produktet organike, si dhe një vetëdije gjithnjë e më e madhe për përfitimet e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm⁶.

Programi Kombëtar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, hartimi i të cilit është financuar nga Bashkimi Evropian, ofron mbështetje financiare për fermerët që kalojnë në praktika organike. Organizatat e shoqërisë civile, si Organika, luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në promovimin e bujqësisë organike në Kosovë^{7,8}.

Shkalla e përdorimit të materialeve qarkore

Treguesi tregon pjesën e materialit të rikuperuar dhe të rikthyer në ekonomi - dhe kështu duke kursyer nxjerrjen e lëndëve të para primare - në përdorimin e përgjithshëm të materialeve.

Nuk është vlerësuar: Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerësimin e treguesit

Kosova është ende duke zhvilluar infrastrukturën e saj të ekonomisë qarkore dhe politikat kombëtare. Shkalla e përdorimit të materialeve qarkore u rrit nga 1% në vitin 2010 në 4.6% në vitin 2022, kryesisht e nxitur nga riciklimi i mbetjeve komunale. Në vitin 2021, Kosova ricikloi 21.307 ton mbetje^{9,10}.

Vendi ka vendosur objektiva strategjike për ekonominë qarkore në Strategjinë për Menaxhimin e Integruara të Mbetjeve, duke u përqendruar në rritjen e ndërgjegjësimit, promovimin e inovacionit në parandalimin e mbetjeve dhe krijimin e sistemeve të ripërdorimit. Qëllimi është rritja e riciklimit me 50% deri në vitin 2035 krahasuar me nivelet e vitit 2023¹¹.

⁴ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Kosovo_Green_Report_2022.pdf

⁵ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Kosovo_Agriculture_in_numbers_2023.pdf

⁶ https://ekoconnect.org/tl_files/eko/p/Projekte/MOE-Laenderberichte/Country-Report-Organic-KOSOVO-EkoConnect-2022.pdf

⁷ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/NATIONAL_PROGRAM_FOR_AGRICULTURE_AND_RURAL_DEVELOPMENT_20232027.pdf

⁸ <https://organika-ks.org/about/>

⁹ https://www.eionet.europa.eu/etcs/etc-ce/products/etc-ce-products/etc-ce-report-5-2022-country-profiles-on-circular-economy/kosovo-ce-country-profile-2022_for-publication.pdf

¹⁰ <https://askdata.rks->

[gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Environment_Mbeturinat_Anketa%20e%20MbeturinaVe%20t%C3%AB%20Trajtuara/tab1.px/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Environment_Mbeturinat_Anketa%20e%20MbeturinaVe%20t%C3%AB%20Trajtuara/tab1.px/)

¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=42930>

Politika të tjera përfshijnë Udhërrëfyesin e Ekonomisë Qarkore, i cili përshkruan fushat prioritare për tranzicion, dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve nga Ndërtimi dhe demolimi, duke synuar një normë riciklimi prej 20% deri në vitin 2030^{12,13}.

Kosova gjithashtu ka potencial të mirë për të miratuar modele biznesi për ripërdorimin që mund të zvogëlojnë mbeturinat plastike me 23% deri në vitin 2040¹⁴.

Iniciativa të ndryshme nga organizatat e shoqërisë civile dhe partneritetet e sektorit privat përqendrohen në rritjen e përdorimit të materialeve rrethore, uljen e mbeturinave dhe promovimin e konsumit të qëndrueshëm. Këto përpjekje janë hapa kyç drejt avancimit të një ekonomie rrethore në Kosovë^{15,16}.

Humbjet ekonomike të lidhura me klimën

Treguesi tregon humbjet totale ekonomike nga ngjarjet ekstreme të lidhura me motin dhe klimën (si stuhitë e erës, përmbytjet, valët e nxehtësisë, periudhat e të ftohtit, thatësitat ose zjarret në pyje) për vend dhe për vit (që nga viti 1980). Një mesatare lëvizëse për 30 vitet e mëparshme shtohet për shkak të ndryshueshmërisë së madhe ndërvjetore të humbjeve

Nuk është vlerësuar: Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerësimin e treguesit

Kosova është e prirur ndaj fatkeqësive natyrore si thatësitat, zjarret, rrëshqitjet e tokës dhe përmbytjet, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në aktivitetin ekonomik, stabilitetin fiskal dhe popullatat e cënueshme¹⁷. Parashikimet tregojnë ngrohje më të lartë rajonale, ulje të reshjeve vjetore dhe përmbytje më të shpeshta pranverore, duke çuar në mungesë uji në disa pellgje lumore^{18,19}.

Përmbytjet e fundit shkaktuan dëme ekuivalente me 0.9% të produktit të brendshëm bruto, duke prekur rreth 10.000 njerëz në vit dhe duke rezultuar në humbje prej afërsisht 50 milionë dollarë amerikanë në produktin e brendshëm bruto^{20,21}.

¹² https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_8171e270-643b-4de3-9387-91794084eb8b.pdf

¹³ https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2024_d98ffb20-5fb9-432f-836a-5900696ed52a.pdf

¹⁴ https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2024_4f390e54-a8a9-45ab-b282-55cebb41fa6f.pdf

¹⁵ <https://www.giz.de/en/downloads/giz2023-en-kosovo-reusable-packaging-systems-and-women-participation.pdf>

¹⁶ https://www.oek-kcc.org/wp-content/uploads/2023/11/Analysis_of_recycling_value_chain_in_Kosovo_English_version1663590143.pdf

¹⁷ <https://portals.iucn.org/library/node/51400>

¹⁸ <https://www.elibrary.imf.org/view/journals/002/2023/200/article-A002-en.xml>

¹⁹ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099100324121037634/pdf/P17920519a54a30bb1abe41c87eaa27d582.pdf>

²⁰ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/958801481798204368/pdf/111015-REVISED-WP-ECA-Country-risk-profiles-PUBLIC.pdf>

²¹ <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-05/hbda-bpda-in-kosovo-following-the-january-2023-floods.pdf>

Në vitin 2023, vetëm përmytjet shkaktuan 3.75 milionë euro dëme në familje^{22,23}.

Ndikimet klimatike në burimet ujore pritet të dëmtojnë sektorët bujqësorë dhe pyjorë, duke kërcënuar sigurinë e të ardhurave të familjeve rurale¹¹. Banka Botërore vlerëson humbjet nga zjarret në pyje në 1.368 euro/ha, me 14.144 ha të prekura nga viti 2008 deri në vitin 2018²⁴.

Strategjia Kombëtare për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Strategjia e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike nxjerrin në pah angazhimin e Kosovës për të rritur qëndrueshmërinë dhe për të zvogëluar cenueshmërinë. Të dyja strategjitë ofrojnë masa të qarta për të adresuar rreziqet nga fatkeqësitë dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë.

Zonat tokësore me status të mbrojtur

Treguesi paraqet përqindjen e zonave tokësore të shpallura të mbrojtura, të shprehur si pjesë e sipërfaqes totale tokësore. Treguesi përfshin edhe zonat e mbrojtura përmes masave të tjera efektive të ruajtjes që bazohen në sipërfaqe. Objektivat e BE-së dhe ato globale synojnë mbrojtjen e 30 % të territorit tokësor.

Nevojitet përshpejtim: Synimi nuk do të arrihet nëse vazhdohet me trendin historik të deritanishëm




Figura 2: Përqindja e zonave tokësore të mbrojtura

Burimi i të dhënave: *Terrestrial protected areas in Europe, EEA & AMMK*

²² <https://pro.drc.ngo/resources/news/kosovo-vulnerable-populations-at-risk-from-effects-of-climate-change/>

²³ <https://www.linkedin.com/pulse/navigating-climate-challenges-kosovos-agricultural-marie-grovel-g17ue>.

²⁴ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/282361468047686579/pdf/750290ESW0P1310LIC00Kosovo0CEA0Rprt.pdf>.

Pjesa e zonave tokësore të shpallura të mbrojtura në Kosovë përbënte 11.6 % të territorit në vitin 2022 (shih grafikun). Që nga viti 2005, numri i zonave të mbrojtura është rritur ndjeshëm, nga nën 50 në mbi 250 zona ²⁵. Megjithatë, nëse ky trend vazhdon, Kosova nuk do të arrijë targetin evropian prej 30 % për zonat tokësore të mbrojtura deri në vitin 2030. Kosova ka 2 parqe kombëtare, 19 rezervate natyrore strikte, 230 monumente natyrore, 7 peizazhe të mbrojtura, 1 park natyre dhe 1 zonë menaxhimit të habitatit.

Aktualisht, Kosova nuk ka një objektiv të përcaktuar për rritjen e zonave të mbrojtura të shpallura²⁶. Megjithatë, Zbatimi i masave të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim pritet të rrisë pjesën e zonave të mbrojtura, sikurse edhe fillimi i shpalljes së zonave Natura 2000²⁷. Shpallja dhe mbrojtja e zonave paraqet sfida për shkak të çështjeve ligjore, pronësisë së tokës, mjedisit, ekonomisë dhe politikave. Ndërsa po ndërmerren përpjekje për t'i adresuar këto sfida, ende ka shumë punë për të siguruar shpallje, mbrojtje dhe mbështetje të duhur.

Konsumimi përfundimtar i energjisë

Treguesi paraqet konsumin përfundimtar të energjisë nga përdoruesit përfundimtarë për të gjitha përdorimet e energjisë.

Drejtimit i gabuar: Trendi historik nuk është duke shkuar në drejtimin e arritjes së synimit




Figura 3: Konsumimi përfundimtar i energjisë
Burimi i të dhënave: *Final energy consumption*, Eurostat

²⁵ <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raport%20vjetor%20p%C3%ABr%20gjendjen%20e%20mjedisit%20ANG%20ueb.pdf>

²⁶ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/Eng-SAPB-2016-2020.pdf>

²⁷ https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/3-PKZMSA-2022-2026_ang.pdf

Një rritje lineare e konsumit përfundimtar të energjisë primare u vërejt në Kosovë gjatë periudhës 2008–2020, me një mesatare prej 1.4 % në vit. Megjithëse ka pasur përparim në vitet e fundit, trendi afatgjatë nuk po lëviz drejt objektivit politik të BE-së për vitin 2030 ^{28, 29}.

Sektoret që konsumojnë më shumë energji janë ndërtesat, transporti dhe industria. Konsumi i lartë i energjisë në këto sektorë lidhet me prodhimin e brendshëm bruto dhe me popullsinë, për shkak të një sërë faktorësh, përfshirë humbjet e larta në rrjet dhe përdorimin e ndërtesave joefikase dhe teknologjive të vjetruara në sektorin rezidencial dhe komercial ^{30, 31}.

Strategjia energjetike e Kosovës 2022–2031 përcakton objektivat kryesore për vitin 2030, duke përfshirë ³²:

- Përmirësimin e treguesve të cilësisë së furnizimit me 32 %.
- Nisjen e shërbimeve rezervë të bazuara në treg.
- Arritjen e një kapaciteti të rregullimit fleksibël prej të paktën 170 MW.
- Zvogëlimin e humbjeve në transmetim sipas normave teknike aktuale të BE-së.
- Zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje në 9 % humbje teknike.
- Kufizimin e konsumit përfundimtar të energjisë në nivelin 1 877 ktoe.
- Arritjen e kursimeve të grumbulluara të energjisë prej 266.4 ktoe në ndërtesa, duke përfshirë ato publike, private dhe komerciale.
- Certifikimin e 150 ndërtesave me afërsisht zero energji.

²⁸ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Energy_Yearly%20indicator/tab6.px/

²⁹ https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Resources_and_green_transformation_in_enlargement_countries

³⁰ <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-1-1.pdf>

³¹ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/sdg_07_11/default/table

³² [file:///C:/Users/iliriana.orana/Downloads/20230714_Final%20Version_First%20Draft%20NECP%202025-2030%20of%20Kosovo%20\(3\).pdf](file:///C:/Users/iliriana.orana/Downloads/20230714_Final%20Version_First%20Draft%20NECP%202025-2030%20of%20Kosovo%20(3).pdf)

Ndikimet shëndetësore nga ndotja e ajrit

Treguesi paraqet numrin vjetor të vdekjeve të parakohshme që i atribuohen ekspozimit ndaj grimcave të imëta të materies (PM_{2.5}), si dhe objektivin përkatës të planit të veprimit “Zero Ndotje” për vitin 2030.

Nuk është vlerësuar: Standardi nuk zbatohet

Vdekjet e parakohshme llogariten duke u bazuar në një qasje të vlerësimit të rrezikut shëndetësor, sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Evropën, e cila mat ndikimin e përgjithshëm të ndotjes së ajrit në një popullatë të caktuar.




Figura 4: Vdekjet e parakohshme për shkak të ekspozimit ndaj grimcave të imëta (PM_{2.5}) në Evropë
Burimi i të dhënave: *Burden of disease of air pollution (Countries & NUTS), EEA*

Ndikimet shëndetësore të ndotjes së ajrit në Kosovë janë ulur ndjeshëm ndërmjet viteve 2005 dhe 2024, kryesisht si rezultat i përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe masave të marra në sektorë të ndryshëm. Kjo ka çuar në një ulje të ekspozimit të qytetarëve të Kosovës ndaj ndotjes së ajrit^{33,34}. Ulja e përqendrimeve të grimcave të imëta me diametër 2.5 mikrometra ose më pak (PM_{2.5}) i atribuohet përpjekjeve për të reduktuar emetimet direkte dhe ato të paraprijësve të grimcave dytësore, si oksidet e azotit dhe përbërjet organike të paqëndrueshme jo-metanike. Burimet kryesore të emetimeve të PM_{2.5} përfshijnë djegien në shkallë të vogël, transportin dhe industrinë^{35,36}.

³³ https://discomap.eea.europa.eu/App/AQViewer/index.html?fqn=Airquality_Dissem.ebd.countries_and_nuts&fqn=Airquality_Dissem.hra.countries_sel

³⁴ <https://www.eea.europa.eu/en/analysis/maps-and-charts/kosovo-air-pollution-country-2023-country-fact-sheets>

³⁵ https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Emission_Inventory_Executive_Summary_Eng.pdf

³⁶ <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Report%20-%20Air%20Pollution%20in%20Kosovo.pdf>

Megjithë përmirësimet, cilësia e ajrit në Kosovë mbetet shqetësuese, sidomos kur krahasohet me udhëzimet e OBSH-së të vitit 2021. Megjithatë, prirjet aktuale tregojnë një përafrim me objektivat e BE-së për cilësinë e ajrit deri në vitin 2030. Politikat kombëtare, përfshirë izolimin e ndërtesave, zgjerimin e sistemeve të ngrohjes, reformat në transport, përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe teknologjitë industriale të pastra, synojnë arritjen e këtij qëllimi ^{37,38}.

Edhe pse është bërë përparim, ndikimet shëndetësore nga PM2.5 mbeten një çështje serioze, që kërkon përpjekje të vazhdueshme, rregullore më të rrepta dhe investime në teknologji më të pastra. Përafrimi me standardet e BE-së dhe ndërhyrjet e synuara në shëndetin publik do të jenë thelbësore për të reduktuar më tej këto ndikime³⁹.

Përqindja e energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë

Treguesi paraqet konsumin bruto final të energjisë nga burime të rinovueshme (BRE), i shprehur si përqindje ndaj konsumit bruto final të energjisë nga të gjitha burimet.

Drejtim i gabuar: Trendi historik nuk është duke shkuar në drejtimin e arritjes së synimit




Figura 5: Përqindja e energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë
Burimi i të dhënave: *Share of energy from renewable sources*, Eurostat

³⁷ <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-1-1.pdf>

³⁸ https://mit-ks.net/repository/docs/2024_05_13_195223_MTS_ANG.pdf

³⁹ https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/3-PKZMSA-2022-2026_ang.pdf

Objektivi kombëtar për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (**BRE**) në Kosovë u përcaktua nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë në vitin 2012 dhe u konfirmua me miratimin e legjislacionit dytësor nga Ministria e Ekonomisë e Kosovës. Pjesëmarrja e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë është rritur në mënyrë të moderuar gjatë viteve të fundit. Në vitin 2020, Kosova e tejkaloi objektivin e saj për një pjesëmarrje prej 25 % të BRE. Kjo rritje e energjisë së ripërtëritshme është kryesisht rezultat i rritjes së prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes nga biomasa, burimet ujore, era dhe dielli ^{40,41}.

Megjithë këtë rritje, pjesëmarrja e energjive të ripërtëritshme në konsumin final të energjisë mbetet e ulët (19 % në vitin 2022) në krahasim me objektivat e Bashkimit Evropian⁴².

Për të arritur objektivin e politikave të BE-së, nevojitet një përsheptim prej rreth 11.9 herë. Parashikohet që në vitin 2030 prodhimi i energjisë elektrike nga BER të arrijë në 261 ktoe, ku pjesa më e madhe do të vijë nga era (55 %), e ndjekur nga dielli (32 %) dhe hidroenergji (12 %).

Sa i përket kapacitetit të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike, 59 % e tij në vitin 2030 do të jetë nga burime të ripërtëritshme. Biomasa pritet të mbetet lënda kryesore e përdorur në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes, me një pjesëmarrje prej 92 % në vitin 2030, e cila pritet të ulet gradualisht në rreth 80 % deri në vitin 2040 ⁴³.

Emetimet dhe largimet e gazrave serrë në tokë dhe pyje

Treguesi tregon emetimet totale neto të gazrave serrë (+) dhe largimet (-) për sektorin e përdorimit të tokës, ndryshimit të përdorimit të tokës dhe pylltarisë (LULUCF).

Nuk është vlerësuar: Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerësimin e treguesit

Pyjet në Kosovë janë burimi më i madh i karbonit dhe kanë një ndikim të madh në trendin e përdorimit të tokës, ndryshimit të përdorimit të tokës dhe sektorit pyjor. Ky burim është rritur pas një trendi në rënie në heqjen e druve të zjarrit dhe një trendi në rritje në sekuestrimin e dioksidit të karbonit (CO₂) në biomasën pyjore⁴⁴.

⁴⁰ <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-1-1.pdf>

⁴¹ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Energy_Yearly%20indicator/tab1.px/

⁴² https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/nrg_ind_ren/default/table?lang=en

⁴³ https://www.energy-community.org/dam/jcr:e6badfbc-313d-4ebc-a450-416dcdbd5499/20230714_Final%20Version_First%20Draft%20NECP%202025-2030%20of%20Kosovo.pdf

⁴⁴ [https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Raporti_GHG_2014-2019_\(final_ueb_version\).pdf](https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Raporti_GHG_2014-2019_(final_ueb_version).pdf)

Bazuar në rezultatet e Inventarit Kombëtar të Pyjeve pyjet janë kategoria kryesore e përdorimit të tokës, me rreth 47%. Krahasuar me inventarin e kryer në vitin 2002, sipërfaqet e pyjeve, livadheve dhe kullotave, si dhe vendbanimet janë rritur, ndërsa sipërfaqet e tokës bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera tokësore janë zvogëluar^{45,46}. Sipas të dhënave nga Corine Land Cover (2018), pyjet dhe zonat gjysmënatyrore mbizotërojnë, me rreth 57%, të ndjekura nga toka bujqësore, me rreth 38%, ndërsa zonat artificiale përfaqësojnë mbi 4.6% të totalit⁴⁷. Trendet e ardhshme të rritjes së burimeve nga pyjet drejtohen kryesisht nga ambiciet e Strategjisë Pyjore të reflektuara në modelimin e skenarit me masat ekzistuese. Strategjia përcakton objektivat për uljen e prerjes së paligjshme të pyjeve me 70% deri në vitin 2030 dhe rritjen e sipërfaqes pyjore me 3% midis viteve 2022 dhe 2030^{48,49}.

Emetimet totale të gazrave serrë (pa LULUCF)

Treguesi tregon trendin në emetimet totale të gazrave serrë, duke përjashtuar ato nga sektori i përdorimit të tokës, ndryshimit të përdorimit të tokës dhe pylltarisë (LULUCF). Për krahasim, përfshihen dy linja indeksi (vlera e vitit 1990 = 100): e para i referohet emetimeve specifike të vendit, ndërsa e dyta shpreh emetimet totale të BE-së.

Nuk është vlerësuar: Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerësimin e treguesit

Emetimet totale të gazrave serrë (GS) në Kosovë kanë qenë pothuajse të qëndrueshme që nga viti 2008, me një rënie në vitin 2014 dhe një rritje në vitin 2016^{50,51}. Sipas inventarit të GS-ve të vitit 2021, sektori i energjisë është kontribuesi më i madh, duke përbërë 87% të emetimeve, i ndjekur nga bujqësia, pylltaria dhe përdorimi i tokës (7%), prodhimi industrial dhe përdorimi i produkteve (2%) dhe sektori i mbeturinave (4%). Emetimet nga sektori i energjisë drejtohen kryesisht nga industritë e energjisë^{52,53}.

⁴⁵ https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Mjedisi_i_Kosov%C3%83%C2%ABs_2020_Raport_i_treguesve_mjedisor%C3%83%C2%AB_-_ANGLISHT.pdf

⁴⁶ <https://www.lfmwb.net/wp-content/uploads/2024/02/National-Forest-Inventory-2012.pdf>

⁴⁷ [https://land.copernicus.eu/en/products/corine-land-cover/clc2018?tab=download%20\(CLC](https://land.copernicus.eu/en/products/corine-land-cover/clc2018?tab=download%20(CLC)

⁴⁸ https://www.energy-community.org/dam/jcr:e6badfbc-313d-4ebc-a450-416dcdbd5499/20230714_Final%20Version_First%20Draft%20NECP%202025-2030%20of%20Kosovo.pdf

⁴⁹ <https://www.german-economic-team.com/en/publication/national-energy-and-climate-plan-necp-of-the-republic-of-kosovo-the-afolu-sector/>

⁵⁰ [https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Raporti_GHG_2014-2019_\(final_ueb_version\).pdf](https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Raporti_GHG_2014-2019_(final_ueb_version).pdf)

⁵¹ https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/RAPORTI_GHG_2008-2013.pdf

⁵² <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Definition%20of%20base%20year%20for%20GHG%20emissions%20estimation%20for%20Kosovo%20-%202022.pdf>

⁵³ <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ANNUAL%20REPORT%20on%20the%20State%20of%20the%20Environment%202022%20ENG%20-%20Final.pdf>

Kosova, duke mos qenë anëtare e OKB-së, nuk është nënshkruese e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike ose Marrëveshjes së Parisit, por ka paraqitur vullnetarisht Kontribute të Përcaktuara në Nivel Kombëtar dhe raporton të dhënat e GS-ve në Agjencinë Evropiane të Mjedisit^{54,55}.

Objektivi i GS-ve të Kosovës për vitin 2030, i miratuar nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, është një ulje prej 16.3% nga nivelet e vitit 2016, ekuivalente me 8.95 kt ekuivalent të dioksidit të karbonit. Skenarët e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës tregojnë se emetimet e GS-ve do të jenë më të ulëta se ky objektivi. Planet e Kosovës për Reduktimin e Emetimeve përqendrohen në energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, modernizimin e transportit, menaxhimin më të mirë të mbeturinave dhe bujqësinë e qëndrueshme⁵⁶.

Pavarësisht sfidave si varësia nga qymyri dhe burimet e kufizuara financiare, Kosova po bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare, përfshirë BE-në, për të përmbushur objektivat klimatike dhe për të zbatuar masat e nevojshme.

Gjenerimi total i mbeturinave

Treguesi paraqet sasinë totale të mbeturinave të gjeneruara nga të gjitha llojet e mbeturinave, përfshirë të gjitha sektorët ekonomikë dhe ekonomitë familjare, dhe e krahason atë me zhvillimin ekonomik, i cili matet përmes produktit të brendshëm bruto (PBB).

Drejtimit i gabuar: Trendi historik nuk është duke shkuar në drejtimin e arritjes së synimit

⁵⁴ <https://cdr.eionet.europa.eu/xk/un/coltaf8la/envzhfohg/>

⁵⁵ [https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/DECISION%20GRK%20NO.%2020253%20The%20Nationally%20Determined%20Contribution%20\(NDC\)%20of%20Kosovo.pdf](https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/DECISION%20GRK%20NO.%2020253%20The%20Nationally%20Determined%20Contribution%20(NDC)%20of%20Kosovo.pdf)

⁵⁶ https://www.energy-community.org/dam/jcr:e6badfbc-313d-4ebc-a450-416dcdbd5499/20230714_Final%20Version_First%20Draft%20NECP%202025-2030%20of%20Kosovo.pdf




Figura 6: Gjenerimi total i mbeturinave

Burimi i të dhënave: *Generation of waste by waste category, hazardousness and NACE Rev. 2 activity, Eurostat*
Gross domestic product (GDP) and main components per capita, Eurostat

Vlerësimet për gjenerimin e mbeturinave dhe për GDP-në bazohen në vlerat për kokë banori. Vlera për vitin 2010 është e vlerësuar (e përafërt). Gjenerimi i mbeturinave komunale në Kosovë është rritur nga 100 kg për frymë në vitin 2010 në 292.5 kg për frymë në vitin 2022 ^{57,58}. Gjatë të njëjtës periudhë, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë është rritur me 84 %, nga 2.981 USD në 5.291 USD ⁵⁹.

Shumica e mbeturinave komunale depozitohen në deponi sanitare, ndërsa normat e depozitimit janë rritur në mënyrë të qëndrueshme midis viteve 2010 dhe 2020 ^{60,61}. Rritja e gjenerimit të mbeturinave dhe e PBB-së lidhet me konsumin më të lartë, rritjen ekonomike, investimet në infrastrukturën publike dhe kontributet e diasporës ⁶².

Megjithatë, prirja e gjenerimit të mbeturinave komunale nuk është në përputhje me objektivat e politikave të BE-së për vitin 2030.

⁵⁷ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/env_wasgen_custom_10317000/default/table

⁵⁸ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Environment_Mbeturinat_Anketa%20e%20Mbeturinave%20Komunale/env02.px/

⁵⁹ <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?locations=XK>

⁶⁰ [https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20mbeturinave%20komunale%20p%C3%ABr%20viti%202021_%20eng\(1\).pdf](https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20mbeturinave%20komunale%20p%C3%ABr%20viti%202021_%20eng(1).pdf)

⁶¹ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Environment_Mbeturinat_Anketa%20e%20Mbeturinave%20Komunale/mbeturinat.px/

⁶² <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>

Strategjia e integruar për menaxhimin e mbeturinave të Kosovës 2024–2035 synon të rrisë riciklimin e mbeturinave komunale me 50 % deri në vitin 2035 dhe të ulë depozitimin e mbeturinave me 70 % krahasuar me nivelet e vitit 2023⁶³.

Për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave, Kosova po përshtat standardet e BE-së, po promovon riciklimin, po zbaton parimet e ekonomisë qarkore, dhe po forcon sistemet e mbledhjes dhe ndarjes së mbeturinave. Edukimi publik dhe nxitjet për reduktimin e mbeturinave janë përbërës kyç të strategjisë, megjithëse mbeten ende sfida për t'u adresuar.

⁶³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=42930>

2. Sfidat socio-ekonomike

Kapërcimi i barrierave për mënyra jetese të qëndrueshme: arsimi dhe vetëdijesimi si elementë kyç për ndryshim

Pavarësisht investimeve mjedisore në menaxhimin e ujit, turizëm dhe eficiencë energjetike, Kosova përballet me sfida në promovimin e mënyrave të jetesës së qëndrueshme për shkak të varësisë së madhe nga karburantet fosile (65% e konsumit të energjisë) dhe varfërisë energjetike (që prek 40% të familjeve), të cilat pengojnë adoptimin e alternativave të qëndrueshme. Në vitin 2020, Kosova reformoi kurrikulën duke përfshirë alfabetizimin mjedisor, duke theksuar çështjet ekologjike dhe qëndrueshmërinë [12] [13]. Së bashku me investimet në mësim të vazhdueshëm dhe vetëdijesim publik, këto përpjekje synojnë të nxisin ndryshime sociale.

Sfida në kalimin drejt një ekonomie qarkore dhe uljen e varësisë nga karburantet fosile

Kosova ka bërë përparim me taksimin mjedisor, i cili kontribuoi 3% të produktit të brendshëm bruto në vitin 2022. Megjithatë, varësia nga karburantet fosile dhe subvencionet (shuma prej 12.7 milionë EUR në 2018–2019) mbeten pengesa për përputhjen me politikat e BE-së. Riorientimi i këtyre subvencioneve drejt energjisë së ripërtëritshme dhe iniciativave të ekonomisë qarkore është thelbësor për arritjen e objektivave të qëndrueshmërisë së BE-së. Përputhja më e mirë me rregulloret e BE-së mund të hapë gjithashtu mundësi financimi për projekte të zhvillimit të gjelbër.

Lançimi i “hartës rrugore të ekonomisë qarkore” shënon një hap kyç drejt një modeli ekonomik të qëndrueshëm. Kjo hartë rrugore priorizon fushat për tranzicion bazuar në ndikimin ekonomik (kontributi në PBB, vlera e shtuar bruto, punësimi) dhe potencialin rrethor (menaxhimi i mbeturinave, përdorimi i resurseve dhe energjisë) [14]. Këto përpjekje synojnë ta pozicionojnë Kosovën më afër kornizave të BE-së për zhvillim të gjelbër.

Roli i komunitetit të biznesit dhe adaptimi ekonomik

Tranzicioni i Kosovës drejt qëndrueshmërisë kërkon një qasje të integruar që përfshin si politikat qeveritare ashtu edhe pjesëmarrjen aktive të sektorit privat. Bizneset, si drejtues kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe inovacionit, janë thelbësore për avancimin e përpjekjeve për qëndrueshmëri, të mbështetura nga korniza politike dhe objektivat kombëtare të Kosovës [15][16].

Qeveria mund t'i ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të adoptojnë praktika më të gjelbra përmes stimuljeve financiarë, mbështetjes teknike, rregulloreve të thjeshtuara dhe prokurimit publik. Veprimet aktuale të qeverisë, të përputhura me qëllimet e integritit në BE, janë premtuese, por zgjerimi i këtyre masave do të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të kalojnë tranzicionin pa kosto të tepruar, duke nxitur një ekonomi më të gjelbër dhe më të qëndrueshme [17][6].

Sfida e pabarazisë: menaxhimi i varfërisë energjetike në tranzicionin e gjelbër

Varfëria energjetike prek një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Kosovës, me pothuajse 40% të familjeve që nuk mund të përballojnë ngrohje adekuate. Kjo jo vetëm që përkeqëson kushtet e jetesës, por pengon gjithashtu adoptimin e praktikave të qëndrueshme. Ligji për Eficiencën e Energjisë adreson këtë çështje duke promovuar eficiencën në ndërtesat banesore, veçanërisht për familjet në nevojë [18].

Programi social i mbështetjes energjetike i Kosovës ofron ndihmë për kostot e ngrohjes, por mbetet i kufizuar në shtrirje, shpesh nuk i plotëson nevojat e popullsisë së rrezikuar. Për të siguruar një tranzicion të drejtë, Kosova duhet të japë prioritet subvencioneve të synuara për teknologjitë e eficiencës energjetike, ndihmës financiare për shërbimet utilitare dhe rrjeteve sociale për të zbutur rritjen e kostove. Zgjerimi i mundësive për punë të gjelbra, veçanërisht në energjinë e ripërtëritshme dhe menaxhimin e mbeturinave, mund të ndihmojë gjithashtu në shpërndarjen më të gjerë të përfitimeve ekonomike.

2.1. Treguesit për aspektet socio-ekonomike

Varfëria energjetike

Treguesi paraqet numrin e familjeve që nuk janë në gjendje të mbajnë shtëpinë e tyre të ngrohtë në mënyrë adekuate, si pjesë e totalit të familjeve (varfëria energjetike). Ai bazohet në anketën vjetore të Bashkimit Evropian mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC).




Figura 7: Përqindja e familjeve të prekura nga varfëria energjetike

Burimi i të dhënave: *Inability to keep home adequately warm*, Eurostat

Taksat mjedisore

Treguesi paraqet të ardhurat nga taksat mjedisore, të shprehura si pjesë e të ardhurave totale nga taksat. Si, Programi i 8-të i Veprimit për Mjedisin, ashtu edhe Pakti i Gjellbër Evropian theksojnë rëndësinë e tatimit mjedisor për të mbështetur parimin “ndotësi pagan”.




Figura 9: Taksat mjedisore si pjesë e të ardhurave totale tatimore

Burimi i të dhënave: *Environmental tax revenues*, Eurostat

Koeficienti Gini i të ardhurave të disponueshme të ekuivaluara

Koeficienti Gini mat pabarazinë e të ardhurave duke përcaktuar se si shpërndahet të ardhura në një popullsi.

-Vlera 0 tregon barazi absolute, ku të gjithë qytetarët e një vendi kanë të njëjtat të ardhura.

-Vlera 100 tregon pabarazi maksimale, ku një individ ka të gjitha të ardhurat e vendit, ndërsa të gjithë të tjerët nuk kanë asgjë.




Figura 10: Koeficienti Gini i të ardhurave të disponueshme të ekuivaluara
Burimi i të dhënave: *Gini coefficient of equivalised disposable income by age, Eurostat*

Vlera bruto e shtuar e sektorit të mallrave dhe shërbimeve mjedisore

Treguesi tregon vlerën bruto të shtuar të Sektorit të Mallrave dhe Shërbimeve Mjedisore (EGSS) si pjesë e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Sektori i mallrave dhe shërbimeve mjedisore përfshin prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve që përdoren për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve.




Figura 11: Vlera e shtuar bruto e EGSS si pjesë e GDP-së
Burimi i të dhënave: *Production, value added and exports in the environmental goods and services sector, Eurostat*

3. Transformimi sistematik

3.1. Sistemi ushqimor



Bujqësia është një aktivitet ekonomik i rëndësishëm dhe strategjik me prioritet të lartë në Kosovë. Ajo kontribuon ndjeshëm në zhvillimin ekonomik dhe punësimin, sidomos në zonat rurale, dhe përbën 7.4% të produktit të brendshëm bruto. Sektori bujqësor përfaqëson 16% të vlerës totale të eksporteve, megjithatë Kosova ende varet nga produktet bujqësore të importuara, të cilat përbëjnë 24.4% të importeve të përgjithshme [19].

Bujqësia njihet gjerësisht si një kontribues kryesor i ndotjes difuze, veçanërisht përmes rrjedhjes nga plehrat, pesticidet, emisionet dhe gjenerimi i mbeturinave. Ky sektor përbën rreth 8% të totalit të emisioneve të gazrave serrë në Kosovë [20]. Mbeturinat organike, kryesisht mbeturinat ushqimore, përbëjnë 30% të totalit të mbeturinave komunale në vend [21]. Përdorimi i pesticideve dhe plehrave në bujqësi është rritur vazhdimisht gjatë dekadave të fundit [22][23].

Sistemi ushqimor në Kosovë përballlet me shumë pengesa dhe sfida, si kontrolli i prodhimit ushqimor, sigurimi i një diete të ushqyeshme, menaxhimi i dobët i mbeturinave ushqimore dhe fragmentimi i tokës. Sipas Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, transformimi i praktikave bujqësore ka një rol të rëndësishëm në tranzicionin e qëndrueshëm [24].

Përmes dokumenteve strategjike, Kosova është angazhuar për t'i përputhur sektorët e bujqësisë dhe prodhimit primar me standardet e BE-së, për të rritur kontrollet sanitare në zinxhirin ushqimor, për të përmirësuar infrastrukturën e sigurimit të cilësisë për ushqimin, për të inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm në zonat rurale, promovimin e inovacionit, dixhitalizimin dhe qëndrueshmërinë mjedisore në bujqësi, trajtimin e duhur të mbeturinave ushqimore dhe zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkore [25][9].

Zhvillimi bujqësor i Kosovës mbështetet nga investime në asete fizike, diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit. Bujqit mbështeten gjithashtu me inpute bujqësore, kredi dhe sigurime bujqësore. Subvencionet direkte në bujqësi në vitin 2022 arritën në 57,526,788 EUR, një rritje prej rreth 50% krahasuar me vitin 2021 [19].


Nga iniciativat dhe shembujt e mirë, Programi për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore në Kosovë është për tu vecuar. Ai ka zbatuar disa masa pilot në bizneset e prodhimit ushqimor dhe praktikatat e mira bujqësore, duke reduktuar derdhjen e ujërave të ndotura dhe ndotjen, kursyer ujë dhe përmirësuar menaxhimin e plehut [26][27].

Një shembull tjetër i mirë është Eco Kos LLC, i cili ka krijuar një sistem inovativ për menaxhimin e vajrave dhe yndyrnave të përdorura në bizneset ushqimore (restaurante) duke i mbledhur dhe trajtuar për prodhimin e biokarburanteve [28].

Në Kosovë po shfaqen tendenca të reja në sjelljen e konsumatorëve që ndikojnë në prodhim, import, mbeturina ushqimore dhe ndikimet mjedisore. Këto ndryshime nxisin një kombinim të vetëdijesimit për çështjet e qëndrueshmërisë, ndikimit të trendeve ndërkombëtare dhe politikave qeveritare që inkurajojnë zgjedhje më miqësore për mjedisin.

Megjithatë, pavarësisht përparimit në disa fusha, sfidat vazhdojnë të jenë prezente, sidomos në uljen e sasisë së mbeturinave ushqimore, promovimin e produkteve lokale dhe organike dhe ndryshimin e shprehive të konsumit të popullsisë në përgjithësi. Kërkesa e konsumatorëve për produkte të qëndrueshme, së bashku me përpjekjet e qeverisë dhe shoqërisë civile, mund të nxisin ndryshime pozitive në të ardhmen.

3.2. Sistemi energjetik



Sektori i energjisë në Kosovë përfaqëson shumicën e emisioneve të gazrave serrë në vend, rreth 87% e gazrave lirohen kryesisht nga djegia e karburanteve fosile në sektorin e energjisë, transformimit energjetik, industrisë dhe transportit [29].

Industria e energjisë dhe djegia në shkallë të vogël janë burimet kryesore të ndotjes nga grimcat me diametër 2.5 μm ose më pak, oksidet e azotit dhe dioksidi i sulfurit [30]. Në vitin 2022, qymyri përbënte 59% të konsumit të energjisë primare [31].

Prodhimi i energjisë në Kosovë varet nga karburantet fosile, që përbëjnë rreth 80% të prodhimit të energjisë totale. Burimet e ripërtëritshme përbëjnë vetëm rreth 17% të prodhimit të energjisë primare. Konsumi i energjisë primare u rrit mesatarisht me 1.4% në vit midis 2008 dhe 2020, ndërsa amvisëria dhe trafiku janë sektorët kryesorë konsumues [32].

Kosova përballlet me sfida të ndryshme në transformimin e sistemit të saj energjetik drejt neutralitetit klimatik dhe përmirësimit të sigurisë energjetike. Tranzicioni drejt prodhimit dhe furnizimit më të qëndrueshëm të energjisë është në fazën fillestare.

Këto ndryshime janë nxitur nga reforma politike, zhvillimi teknologjik dhe ndryshimet në sjelljen e konsumatorëve. Instalimi i paneleve diellore, ndërtimi i kapaciteteve të reja të energjisë me erë, standardet e eficiencës energjetike në ndërtesa dhe ndërtimi i rrjeteve të ngrohjes janë disa nga iniciativat e ndërmarra vitet e fundit [33].

Politikat dhe strategjitë kombëtare të ardhshme synojnë të ulin kostot e energjisë, të gjenerojnë përfitime për mjedisin, të ulin emisionet e gazrave serrë, të përmirësojnë sigurinë energjetike dhe të kontribuojnë në zvogëlimin e varfërisë energjetike. Politikat kryesore të vendit, të përfaqësuara nga plani kombëtar për energji dhe klimë dhe strategjia energjetike, fokusohen në tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët duke siguruar furnizimin, uljen e kostove për konsumatorët, rritjen e konkurrencës në treg dhe vazhdimin e integritetit me sistemin energjetik evropian.


Objektivat e strategjisë energjetike përfshijnë një pjesëmarrje prej 35% të burimeve të ripërtëritshme në konsumin përfundimtar të energjisë elektrike, duke synuar shtimin e 1.2 GW kapaciteti energjie nga erë dhe diell dhe 100 MW në segmentin e prosumerëve deri në vitin 2031, me një objektiv ndërmjetës prej 30 MW deri në vitin 2025. Ndërkohë, është planifikuar një kapacitet prej 170 MW për ruajtjen e energjisë me bateri deri në vitin 2031[29][32].

Përmirësimet e eficiencës energjetike në sektorin e ndërtesave realizohen përmes rinovimit, izolimit dhe ngrohjes më efikase. Në përputhje me këtë, është zbatuar një program mbështetës i subvencioneve që synon rritjen e eficiencës energjetike dhe zëvendësimin e pajisjeve të ngrohjes në sektorin banesor. Shuma totale e granteve përfshin një vlerë prej 12.3 milionë EUR [34].

Kosova ka përfituar mbështetje financiare nga BE-ja, me vlerë prej 75 milionë EUR, për transformimin e sistemit energjetik, duke u fokusuar në stimulimin e kursimit të energjisë dhe përmirësimin e eficiencës energjetike, në kuadër të paketës së mbështetjes energjetike për vendet e Ballkanit Perëndimor [35].

Megjithëse është bërë përparim i konsiderueshëm, Kosova duhet të rrisë përpjekjet për t'u përballur me sfidat që lidhen me të ardhmen e sistemit energjetik.

3.3. Sistemi i mobilitetit



Sistemi i mobilitetit është i lidhur ngushtë me sistemet e tjera shoqërore, si urbanizimi, planifikimi hapësinor dhe energjia. Rritja e popullsisë urbane dhe flukset e rritura të mobilitetit kanë shkaktuar shumë sfida për sistemet e mobilitetit në Kosovë [36].

Sektori i transportit përbën 2% të produktit të brendshëm bruto dhe është përgjegjës për 10% të totalit të emisioneve të gazrave serrë. Trafiku mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit, duke përfaqësuar 30% të totalit të emisioneve të dioksidit të azotit dhe 7% të totalit të grimcave me diametër 2.5 µm ose më pak [37][38].

Sektori i transportit përbën 28% të konsumit përfundimtar të energjisë. Mënyra dominuese për transportin e pasagjerëve dhe mallrave është makina ose furgoni me karburante fosile. Në vitin 2023, numri i automjeteve të regjistruara motorike dhe jo-motorike ishte 9.3% më i lartë se në vitin 2020. Kategoria kryesore e automjeteve janë makinat, që përbëjnë 80% të totalit, kryesisht me naftë që plotësojnë standardet Euro 3 dhe Euro 4. Numri i makinave hibride dhe elektrike mbetet shumë i vogël dhe nuk arrin 1% të flotës së vendit [39][40].

Përmirësimi i sigurtisë rrugore mbetet një sfidë e madhe. Shkalla e lartë e pronësisë së makinave dhe motorizimit, e favorizuar nga investimet në infrastrukturën rrugore, ka rritur aksidentet dhe vdekshmërinë në rrugë, megjithëse është arritur përparim i mirë gjatë 20 viteve të fundit. Në vitin 2020, kishte 43 vdekje për milion banorë. Objektivi është ulja e numrit të vdekjeve dhe lëndimeve nga aksidentet rrugore deri në 30% deri në vitin 2030 krahasuar me vitin 2022 [36][41].

Transporti dhe mobiliteti, si një drejtues i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm, vazhdojnë të përmirësohen nga autoritetet kombëtare përmes planifikimit të zgjidhjeve inovative dhe të zgjuara për transportin urban. Megjithatë, ende ka nevojë për dizajnimin e mobilitetit urban dhe kalimin drejt një sistemi më të qëndrueshëm. Strategjia e transportit multimodal për periudhën 2023–2030 promovon transportin e qëndrueshëm përmes disa objektivave dhe synimeve, duke përfshirë rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë që jeton në zona me lidhje të mira transporti deri në 80% krahasuar me bazën prej 40% në vitin 2022, uljen e emisioneve totale në sektorin e transportit deri në 20% dhe rritjen e pjesës së automjeteve me karburante alternative deri në 10% [36][42].

Derisa deri kohët e fundit planifikimi i transportit dhe mobilitetit në qytetet e Kosovës ka qenë kryesisht i orientuar nga transporti motorik, disa qytete kanë filluar të kalojnë drejt politikave më të qëndrueshme të mobilitetit. Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, ka zhvilluar një plan veprimi për qytet të gjelbër.

Objektivat specifike të planit lidhur me transportin dhe mobilitetin parashikojnë investime në rrjetet e transportit publik, duke përfshirë zhvillimin e rrjetit të autobusëve në të gjithë qytetin, infrastrukturën për transportin aktiv dhe zëvendësimin e flotës së automjeteve [43].

Kosova ka një ligj në fuqi që ndalon importin e makinave më të vjetra se 10 vjet. Tarifat doganore dhe taksat janë ulur për automjetet e reja të importuara, dhe ekzistojnë disa iniciativa të vogla për subvencionimin e transportit publik [44]. Kosova aplikon një taksë ekologjike vjetore prej 10 EUR për të gjitha automjetet, si dhe akcizë për produktet e naftës të importuara [45][46].

Referencat

1. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) **Mjedisi i Kosovës 2020 – Raport i treguesve mjedisorë**, Prishtinë, 2021, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
2. Komisioni Evropian, **Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor**, Faqja e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, 2020, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
3. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022–2028**, Prishtinë, 2021, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
4. Programi i Integruar i Menaxhimit të Burimeve Ujore në Kosovë (IWMR-K), **Industria e Qëndrueshme – Nxitja e praktikave të pastra**, 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
5. Programi i Integruar i Menaxhimit të Burimeve Ujore në Kosovë (IWMR-K), **Prezantimi i praktikave miqësore ndaj mjedisit për menaxhimin e plehut në bujqësinë e kafshëve në Kosovë**, 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
6. Eco Kos LLC, 2022, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
7. Qeveria e Kosovës, **Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën i Republikës së Kosovës 2025–2030**, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2023, e qasshme më 25 qershor 2025, [link](#).
8. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), **Raport – Emetimi i gazrave serrë në Kosovë, 2008–2013**, Prishtinë, 2014, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
9. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, **Përzjerja energjetike e Kosovës**, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
10. Ministria e Ekonomisë, **Strategjia energjetike e Republikës së Kosovës 2022–2031**, Prishtinë, 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
11. Komisioni Evropian, **Dokument i punës së stafit të Komisionit – Raporti për Kosovën 2023, SWD(2023) 692 final i datës 8 nëntor 2023**, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
12. Ministria e Ekonomisë, **Programi i Zbatimit të Strategjisë Energjetike të Kosovës (IPESK) për periudhën 2022–2025**, Prishtinë, 2022, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
13. Shërbimi i Jashtëm Evropian, **Ndihmë financiare direkte e BE-së për Kosovën mbi 62 milionë euro, duke kaluar 1.3 miliardë euro**, 24 mars 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
14. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **Strategjia për transportin multimodal 2023–2030**, 2022, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
15. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), **Raport – Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë, 2014–2019**, Prishtinë, 2021, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
16. Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), **Bruto produkti i brendshëm sipas aktiviteteve ekonomike, 2008–2023**, faqe interneti e ASK, 2024, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
17. Grupi i Bankës Botërore, **Kosova: Një e ardhme e transportit të gjellbër dhe ajrit të pastër**, 2020, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
18. Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), **Statistikat e transportit 2023**, Prishtinë, 2024, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
19. Ministria e Infrastrukturës, **Strategjia dhe plani i veprimit për sigurinë rrugore në Kosovë**, 2015, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
20. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **Plani i veprimit i strategjisë për transportin multimodal 2023–2025**, 2022, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
21. Komuna e Prishtinës, **Plani i veprimit për qytetin e gjellbër të Prishtinës**, 2021, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
22. Ligji Nr. 04/L-179 për transportin rrugor, qershor 2013, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
23. Ligji Nr. 05/L-132 për automjetet, maj 2017, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
24. Ligji Nr. 08/L-018 për tregtinë e produkteve të naftës dhe karburantet e rinovueshme, shkurt 2022, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).

-
25. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), **Raporti mbi Emetimin e Gazrave Serrë në Kosovë, 2014–2019**, Prishtinë, 2020, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 26. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), **Raporti vjetor mbi gjendjen e mjedisit 2022**, Prishtinë, 2023, e qasshme më 27 qershor 2025, [link](#).
 27. Agjencia e Statistikave e Kosovës, **Anketa e Ndërmarrjeve Bujqësore 2021**, Prishtinë, 2022, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 28. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), **Mjedisi i Kosovës 2020 – Raport mbi treguesit mjedisorë**, Prishtinë, 2021, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 29. Komisioni Evropian, **Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor**, Faqja e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, 2020, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
 30. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022–2028**, Prishtinë, 2021, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 31. Programi i Integruar i Menaxhimit të Burimeve Ujore në Kosovë (IWMR-K), **Industria e Qëndrueshme – Nxitja e praktikave të pastra**, 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 32. Programi i Integruar i Menaxhimit të Burimeve Ujore në Kosovë (IWMR-K), **Prezantimi i praktikave miqësore ndaj mjedisit për menaxhimin e plehut në bujqësinë e kafshëve në Kosovë**, 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 33. Eco Kos LLC, 2022, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
 34. Qeveria e Kosovës, **Plani kombëtar për energjinë dhe klimën i Republikës së Kosovës 2025–2030**, GIZ, Prishtinë, 2023, e qasshme më 25 qershor 2025, [link](#).
 35. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), **Raport – Emetimi i gazrave serrë në Kosovë, 2008–2013**, Prishtinë, 2014, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 36. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, **Përzjerja energjetike e Kosovës**, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
 37. Ministria e Ekonomisë, **Strategjia energjetike e Republikës së Kosovës 2022–2031**, Prishtinë, 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 38. Komisioni Evropian, **Dokument i punës së stafit të Komisionit – Raporti për Kosovën 2023, SWD(2023) 692 final i datës 8 nëntor 2023**, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 39. Ministria e Ekonomisë, **Programi i zbatimit të strategjisë energjetike të Kosovës (IPESK) për periudhën 2022–2025**, Prishtinë, 2022, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 40. Shërbimi i Jashtëm Evropian, **Ndihmë financiare direkte e BE-së për Kosovën mbi 62 milionë euro, duke kaluar 1.3 miliardë euro**, 24 mars 2023, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 41. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **Strategjia për transportin multimodal 2023–2030**, 2022, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 42. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), **Raport – Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë, 2014–2019**, Prishtinë, 2021, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 43. Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), **Bruto produkti i brendshëm sipas aktiviteteve ekonomike, 2008–2023**, faqe interneti e ASK, 2024, e qasshme më 2 korrik 2025, [link](#).
 44. Grupi i Bankës Botërore, **Kosova: Një e ardhme e transportit të gjellbër dhe ajrit të pastër**, 2020, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 45. Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), **Statistikat e transportit 2023**, Prishtinë, 2024, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).
 46. Ministria e Infrastrukturës, **Strategjia dhe plani i veprimit për sigurinë rrugore në Kosovë**, 2015, e qasshme më 26 qershor 2025, [link](#).



Kontribuesit nga Kosova për përgatitjen e raportit:

Afrim Berisha, NFP

Iliriana Orana, NFP Asistent

European Environment Agency

Kongens Nytorv 6 1050 Copenhagen K Denmark

Tel.: +45 33 36 71 00

Email: info@eea.europa.eu, Web: eea.europa.eu

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja XV/04

Tel.: +381 38 200 74 093

Email: ammk@rks-gov.net; Web: ammk-rks.net